



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:285583

Datë: 01.07.2024

Numri i dokumentit: 05879561

KPPP.nr.2194/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Aritech” SH.P.K., me NUI: 810821828, me seli në rr. “Prishtinë - Lipjan” km. 10, kundër debitorit: Komuna e Mitrovicës, me seli në rr. “Bedri Gjinaj”, p.n., në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbnor Murturi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.166/2023 të datës 30.11.2023 të Përmbaruesit Privat Arben Gashi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 01.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura e përmbarimit e lejuar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.166/2023 të datës 30.11.2023 të Përmbaruesit Privat Arben Gashi, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Aritech” SH.P.K., kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, për shkak të tërheqjes së propozimit për përmbarim nga ana e kreditorit.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat Arben Gashi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Aritech” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr.166/2023 me datën 30.11.2023, kundër debitorit Komuna e Mitrovicës, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 0473/23 të datës 31.08.2023, që t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 14,278.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimore sipas tarifës së përmbaruesve nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit, si dhe me

regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në realizimin e kërkesës së kreditorit.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbarimit me datën 14.12.2023, i autorizuari i debitorit, ka paraqitur prapësim, ndërsa kreditori me datën 15.12.2023 ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Kreditori, me datën 21.06.2024 përmes parashtresës, e ka njoftuar Gjykatën se palët kanë arritur marrëveshje me debitorin dhe se i njëjti tërhiqet nga propozimi për përmbarim i lejuar sipas Urdhrit Përmbarimor P.nr.166/2023 të datës 30.11.2023.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 42 par. 1 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP) i cili përcakton se “*Propozimi për përmbarim mund të tërhiqet tërësisht apo pjesërisht nga kreditori gjatë zhvillimit të procedurës përmbarimore pa pëlqimin e debitorit*” dhe par. 2 të po këtij neni i cili përcakton se “*Në rast të tërheqjes së propozimit për përmbarim organi përmbarues e përfundon përmbarimin në tërësi apo pjesërisht, varësisht nga ajo se a është tërhequr ai në tërësi apo vetëm pjesërisht*“, dhe duke u bazuar në njoftimin e kreditorit se i njëjti tërhiqet nga propozimi për përmbarim këtë çështje përmbarimore e përfundoi në tërësi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 42 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2194/23, datë 01.07.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.